



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

---

**Njoftim Përqendrimi**

Rasti: Përfitim kontrolli: GMBF Investment S.a.r.l / NV Biscuits Delacre SA / United Biscuits Industries SAS

Në datën 22 Korrik 2016, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Ofertës Detyruese për blerjen e aksioneve të NV Biscuits Delacre SA dhe United Biscuits Industries SAS të zotëruara përkatësisht nga United Biscuits Holdco 2 Limited dhe Biscuits France SAS” e nënshkruar nga palët shoqëria GMBF Investment S.a.r.l (Blerësi) dhe shoqërisë United Biscuits Holdco 2 Limited (Shitësi) me objekt përfitim e kontrollit të plotë nëpërmjet përfimit të 100% të aksioneve të shoqërive Target NV Biscuits Delacre SA dhe United Biscuits Industries SAS.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **GMBF Investment S.a.r.l:** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit të Dukatës së Madhe të Luksemburgut. Ajo është një shoqëri holding , pjesë e Grupit Ferrero i cili është aktiv në tregun e prodhimit të produkteve ushqimore, ëmbëlsirave dhe produkteve të ëmbla, etj..
- **NV Biscuits Delacre SA:** është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit të Francës dhe ushtron veprimtari në fushën e prodhimit, reklamimit, shitjes dhe shpërndarjes së biskotave.
- **United Biscuits Industries SAS:** është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit të Belgjikës dhe ushtron veprimtari në fushën e prodhimit, reklamimit, shitjes dhe shpërndarjes së biskotave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 2 , 10, pika 1.b) dhe 12 të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)**